



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së dytë të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, mbajtur më
28.2.2025, e cila filloi në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina, (i pavarur), kryesues i Kuvendit, Trieria Kasumi-Berisha (LVV), Ermal Osmani (LVV), Gëzim Sveçla (LVV), Nora Kelmendi (LVV), Feim Osmani (LVV), Edmond Azemi (LVV), Berat Lahu (LVV), Arianit Beqiri (LVV), Violeta Salihu (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Arbër Limani (LVV), Faton Zeka (LVV), Radie Hoxhaj (LVV), Besart Krasniqi (LVV), Arbnora Berisha (LVV), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Agron Canolli (PDK), Fatmir Dervishi (PDK), Arbnora Ajeti (PDK), Granit Geci (PDK), Liridon Selmani, (PDK), Kumrije Shabani-Ramadani (PDK), Shegë Beqiri-Badivuku (PDK), Gresa Lahu (PDK), Sami Boroci (AKR), Gëzim Mehmeti (AKR), Agim Kuleta (LB).

Munguan: Petrit Reçica (LVV), Berna Saraçi (LVV), Xhavit Ahmeti (AAK), Jeta Rafuna-Hasani (LDK), Ajet Brajshori (LDK), Driton Rukiqi (LDK), Dasmor Durmishi (LDK), Sami Salihu (LDK), Fiknete Bejta (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Amir Simnica (LDK), Milazim Vitija (LDK), Pëllumb Bajçinovci (LDK), Lindita Rexhepi (LDK), Besë Pestreshi (LDK), Elmire Nikçi-Rexha (LDK), Dhurata Jahaj-Retkoceri (LDK), Endrit Zabërgja (NISMA), Bahri Gashi (AAK), Taulant Maxharraj (AAK), Endrit Gashi (AAK), Bukurie Canolli (AAK).

Të pranishëm ishin edhe: Valbona Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Arbër Sadiki, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Bekim Brestovci, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Lulzim Fushtica, drejtor i Drejtorisë së Emergjencave, Donikë Çetta, drejtoreshë e Drejtorisë së Parqeve, përfaqësues të OSBE-së dhe të medieve.

Mbledhjen e hap dhe e kryesoi Fehmi Kupina, kryesues i Kuvendit. Ai tha se për këtë mbledhje është paraparë ky

Rend dite:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të seancës së parë të Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit të memorialit kushtuar artistit Faruk Begolli;

3. Propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për memorialin kushtuar dëshmorëve Hyzri Talla, Afrim Maliqi dhe Ilir Durmishi;
4. Propozim-vendimi për përkrahje financiare për familjet strehuese dhe fëmijët në strehim familjar;
5. Propozim-vendimi për subvencionimin e transportit të nxënësve;
6. Propozim-vendimi për hartimin e Planit të hollësishëm rregullues, Çagllavicë;
7. Propozim-vendimi për ndarjen e mjeteve financiare shoqatës "Yjet që nuk vdesin";
8. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 tetor-30 dhjetor 2024, TMK4;
9. Raporti financiar buxhetori i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2024;
10. Propozim-vendimi lidhur me Planin lokal të veprimit për barazi gjinore 2025-2026;
11. Propozim-vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2025;
12. Propozim-vendim për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për përcaktimin e Komisionin për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve tjera publike në Kryeqytet, si dhe shqyrtimin e kërkesave dhe ankesave për emërtimin e rrugëve, rrugicave, dhe vendeve tjera publike në Kryeqytet, nr. 01-020/0569249/23, të dt.3.4.2023;
13. Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të Strategjisë së Prishtinës për artin dhe kulturën 2026-2031;
14. Propozim-vendimi për miratimin e Rregullores për subvencionet e Komunës së Prishtinës;
15. Pyetje dhe përgjigje;
16. Të ndryshme.

Kryesuesi hapi diskutimin për rendin e ditës.

Ermal Osmani kërkoi nga anëtarët e Kuvendit dhe të pranishmit tjerë, që ta ngushëllojmë familjen e Faik Rexhepit, atdhetarit tonë, i cili me një akt autokton veproi mu në sheshin e Prishtinës, me qëndrimin e tij këmbëkryq përballë reprezalies policore serbe, e që në mënyrë paqësore i dha mesazh botës se jemi autokton në këto troje. Ai frymëzoi shumë breza të ardhshëm për luftën për liri. Andaj, kërkoj nga të gjithë të pranishmit që të mbahet një minutë heshtje.

Gëzim Sveçla kërkoi që në këtë mbledhje të diskutohet për faturat e ngrrohtores "Termokos", një çështje shumë e debatuar gjatë këtyre ditëve, si dhe për çështjen e rënduar me mbeturina në Kryeqytet.

Leutrim Retkoceri tha se ne si GP i kemi disa pika, që është mirë të trajtohen edhe me arsyetuar pse është thirrur seanca me këto pika të rendit të ditës, e pikërisht

propozuesi i këtyre pikave të renditë të ditës, që është Kryetari i Komunës, Përparim Rama, nuk është në seancë. Andaj është e rrugës që ta kemi një pauzë, të koordinohemi rreth propozimeve të reja të rendit të ditës dhe pas një pauze t'i jepet kohë ekzekutivit dhe kryetarit, Përparim Rama, që të vije dhe të arsyetojë pikat që i ka të propozuara, e sidomos të bëjë arsyetimin e një pjese të Planit rregullues, se si është duke i trajtuar tash tokat e Komunës edhe koeficientet në Kryeqytet.

Kryesuesi u shpreh se, duke pasur parasysh diskutimin e anëtarëve të Kuvendit, kërkoj që të bëhet një pauzë njëzetminutëshe.

Pas një pauze njëzetminutëshe, me të filluar vazhdimi i mbledhjes, në mungesë të kuorumit, kryesuesi e konstatoi mbledhjen të mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesues i Kuvendit
Fehmi Kupina

